

Të huajt dhe azilkërkuesit në Shqipëri

Viti 2017

Tiranë, më 22 Gusht 2018: Numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri, në 2017, rezultoi 12.906 banorë, duke shënuar rritje me 3,1 %, krahasuar me 2016.

Gjatë 2017, numri i të huajve rezidentë përbëhet nga 8.395 meshkuj, duke shënuar rritje me 0,9 % krahasuar me 2016, dhe 4.511 femra duke shënuar rritje me 7,5 % krahasuar me 2016.

Gjatë 2017, të huajt me origjinë nga Europa janë 7.637 dhe përbëjnë 59,2 % të të huajve gjithsej kundrejt 66,5 % që përbënin në 2016.

Të huajt për arsye punësimi, në vitin 2017, janë 6.334, dhe përbëjnë 49,1 % të të huajve gjithsej kundrejt 50,0 % që përbënin në 2016.

Të huajt e parregullt, të evidentuar në 2017, janë 1.049 persona, duke pësuar rritje me 14,6 %, krahasuar me vitin 2016.


Të huajt e parregullt të evidentuar në 2017 vijnë kryesisht nga vende si Siria, Algjeria dhe Libia.

Azilkërkuesit në Shqipëri, në 2017, janë 309 persona, duke shënuar rritje me 28,8 %, krahasuar me vitin 2016.

Në 2017, rezultojnë 316 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 12,5 %, krahasuar me vitin 2016.

Në 2017, rezultojnë 651 persona të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, duke pësuar rritje me 32,9 %, krahasuar me vitin 2016.

Fig. 1 Të huajt me leje qëndrimi sipas gjinisë




Të huajt në Shqipëri

Numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2017, përbën rreth 0,4 % të popullsisë rezidente. Gjatë 2017, numri i të huajve rezidentë përbëhet nga 8.395 meshkuj dhe 4.511 femra. Meshkujt zënë 65,0 % në numrin e të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri.

Piramida e të huajve rezidentë në Shqipëri pasqyron qartë një disbalancë gjinore, dhe femrat kanë një moshë relativisht më të re se meshkut.

Fig. 2 Piramida e popullsisë së huaj rezidente në Shqipëri



Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2017, është 9.027 aplikime, duke shënuar rritje me 3,9 %, krahasuar me vitin 2016. Aplikimet më të shumta sipas vendit të origjinës janë nga Irani, Italia, Kosova dhe Turqia, të cilët së bashku përbëjnë 61,8 % të aplikimeve gjithsej në 2017.

Tab. 1 Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës


Vendi i origjinës	2016	2017
Iran	2.195	1.963
Itali	1.694	1.779
Kosove	730	978
Turqi	1.032	863
Greqi	229	295
SHBA	221	280
Kinë	215	259
Siri	167	229
Maqedoni	177	167
Mbretëri e Bashkuar	118	152
Tjetër	1.914	2.062
Gjithsej	8.692	9.027

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt në Shqipëri sipas kontinenteve

Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës në 2017, kryesohen nga vendet e Europës, të cilët zënë 59,2 % të të huajve gjithsej. Të huajt me origjinë nga Europa janë 7.637, duke shënuar rënie me 8,3 %, krahasuar me 2016. Të huajt me origjinë nga Azia janë 3.618, duke shënuar rritje me 11,5 %, krahasuar me 2016. Të huajt me origjinë nga Afrika, Amerika dhe Oqeania janë 1.651, duke pësuar rritje me 73,6 %, krahasuar me 2016.

Fig. 3 Të huajt me leje qëndrimi sipas vendit të origjinës



Të huajt në Shqipëri sipas arsyes

Në vitin 2017, sipas arsyes, të huajt që aplikojnë për leje qëndrimi për punësim zënë 49,1 % të të huajve gjithsej, ndjekur nga aplikimet për bashkim familjar me 23,1 %, aplikimet për qëllime humanitare me 18,4 %, aplikimet për studime me 5,1 % dhe aplikime për arsye të tjera me 4,3 %.

Tab. 2 Të huajt me leje qëndrimi sipas arsyes së aplikimit

Motivi i aplikimit	Punësim	Bashkim Familjar	Studim	Humanitar	Të tjera
2009	5963	622	90	35	83
2010	4148	977	183	42	313
2011	4450	1497	265	44	359
2012	4565	1867	515	47	359
2013	5302	1765	775	229	259
2014	5353	2266	752	441	279
2015	5862	2573	842	863	423
2016	6263	2783	652	2395	426
2017	6334	2982	656	2381	553

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt e parregullt

Të huajt e parregullt të evidentuar në territorin e Shqipërisë ose në kufi, pa dokumentacionin e nevojshëm rezultojnë 1.049 persona në 2017, duke pësuar rritje me 14,6 %, krahasuar me vitin 2016.


Të huajt e parregullt të evidentuar në 2017 vijnë kryesisht nga vende si Siria, Algjeria dhe Libia.

Azilkërkuesit në Shqipëri

Azilkërkuesit në Shqipëri, referuar Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, rezultojnë 309 persona në 2017, me rritje prej 28,8 %, krahasuar me 2016.

Duke analizuar vendin e origjinës së azilkërkuesve në Shqipëri, kuptojmë se shumicën e rasteve e përbëjnë ato me origjinë nga Siria, 111 azilkërkues, me origjinë nga Algjeria, 61 azilkërkues dhe nga Afganistani, 29 azilkërkues për 2017.

Fig. 4 Azilkërkuesit sipas vendit të origjinës



Azilkërkuesit sipas gjinisë

Numri i azilkërkuesve meshkuj në 2017, është 275, duke shënuar rritje me 89,7 %, krahasuar me vitin 2016. Numri i azilkërkuesve femra në 2017, është 34, duke shënuar rënie me 64,2 %, krahasuar me vitin 2016.

Meshkujt dominojnë ndër azilkërkuesit në Shqipëri, duke zënë 89,0 % të numrit gjithsej të tyre në 2017.

Marrja dhe lënia e shtetësisë Shqiptare

Në 2017, rezultojnë 316 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 12,5 %, krahasuar me vitin 2016.

Në 2017, rezultojnë 651 persona të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, duke pësuar rritje me 32,9 %, krahasuar me vitin 2016.

Metodologjia

Përkufizime

I huaj është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

Leje qëndrimi është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.

Person pa shtetësi është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

Leje pune është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, një të huaji, për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.

Bashkim familjar është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë të anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të një të huaji, ose refugjati, banorë në Republikën e Shqipërisë, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.

Anëtarë të familjes së të huajit, azilkërkuesit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykatë apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundin objektivist të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.

Shërbimi vullnetar është një program aktivitetesh solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.

Studiues dhe specialistë janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.

Qëndrim i parregullt është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat e ligjit, i cili respekton normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Marrja e shtetësisë fitohet nga një i huaj që ka paraqitur kërkesë për marrjen e shtetësisë shqiptare, në rast se plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

Lënia e shtetësisë shqiptare nënkupton se pasja e shtetësisë shqiptare merr fund sipas kërkesës së personit, kur ai plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

Azil është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve.

Kërkesë për azil është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdo mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit shqiptar.

Aplikim për azil është kërkesa zyrtare e të huajit ose personit pa shtetësi para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas Konventës së Gjenevës së OKB-së, "Mbi statusin e refugjatit". Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përveç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.

Azilkërkues është çdo i huaj apo person pa shtetësi, që shpreh në çfarëdo mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.

Shtet apo vend i origjinës është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.

Burimi i të dhënave

Të dhëna mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit;

Të dhënat mbi Azil Kërkuesit në Shqipëri sigurohen nga Drejtoria mbi Azilin dhe Shtetësinë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.